



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurori i Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtjarit
dhe Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 8 shkurt 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe për
Parashtrime**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Mbrojtjes së Ismet Bahtjarit

Felisiti Geri

Xhejms O'Kif

Mbrojtjes së Haxhi Shalës

Tobi Kadman

Xhon Kabën

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 96(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 tetor 2023, pas paraqitjes së parë të Sabit Januzit (“z. Januzi”) dhe Ismet Bahtijarit (“z. Bahtijari” dhe “çështja gjyqësore *Januzi dhe Bahtijari*”) më 9 tetor 2023,² u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes.³

2. Më 24 tetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore *Januzi dhe Bahtijari* lëshoi vendim mbi: (i) kornizën për nxjerrjen e provave dhe çështje në lidhje me to; si dhe (ii) kornizën për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontakteve ndërmjet një pale ose pjesëmarrësi dhe dëshmitarëve të palës kundërshtare ose të një pjesëmarrësi (“Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe Bahtijari*”).⁴

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik; KSC-BC-2023-11, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 20 nëntor 2023, publik.

² KSC-BC-2023-10, Transkripti i seancës, 9 tetor 2023, publik f. 1-16; Transkripti i seancës, 9 tetor 2023, publik, f. 17-32. *Shih gjithashtu* F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit dhe Çështje të lidhura me Të*, 6 tetor 2023, publik, para. 21(a)-(b).

³ KSC-BC-2023-10, F00022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 9 tetor 2023, publik; Transkripti i seancës, 12 tetor 2023, publik, f. 33-71.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00076, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje në lidhje me To*, 24 tetor 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, publike. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua në të njëjtën ditë, F00076/RED.

3. Më 3 nëntor 2023, u mbajt konferenca e dytë mbi ecurinë e çështjes në çështjen gjyqësore *Januzi dhe Bahtijari*.⁵
4. Më 14 dhjetor 2023, u mbajt konferenca e tretë mbi ecurinë e çështjes në çështjen gjyqësore *Januzi dhe Bahtijari* ("konferenca e tretë mbi ecurinë e çështjes *Januzi dhe Bahtijari*").⁶
5. Më 15 dhjetor 2023, pas paraqitjes së parë të Haxhi Shalës ("z. Shala" dhe "çështja gjyqësore *Shala*") më 13 dhjetor 2023,⁷ u mbajt konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes ("konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes *Shala*").⁸
6. Më 19 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore *Shala* lëshoi vendim mbi: (i) kornizën për nxjerrjen e provave dhe çështje në lidhje me to; si dhe (ii) kornizën për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontakteve ndërmjet një pale ose pjesëmarrësi dhe dëshmitarëve të palës kundërshtare ose të një pjesëmarrësi ("Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*").⁹
7. Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bashkoi çështjen gjyqësore *Januzi dhe Bahtijari* me çështjen gjyqësore *Shala*.¹⁰

⁵ KSC-BC-2023-10, F00081, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Dytë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime* ("Urdhri për Konferencën e Dytë mbi Ecurinë e Çështjes *Januzi dhe Bahtijari*"), 27 tetor 2023, publik; Transkripti i seancës, 3 nëntor 2023 ("transkripti i konferencës së dytë mbi ecurinë e çështjes *Januzi dhe Bahtijari*"), publik, f. 72-92.

⁶ KSC-BC-2023-10, F00121, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Tretë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 8 dhjetor 2023, publik; Transkripti i seancës, 14 dhjetor 2023, publik, f. 93-134.

⁷ KSC-BC-2023-11, Transkripti i seancës, 13 dhjetor 2023, publik, f. 1-15. *Shih gjithashtu* F00014, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Haxhi Shalës dhe Çështje të lidhura me Të*, 12 dhjetor 2023, publik, para. 22(a).

⁸ KSC-BC-2023-11, F00017, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës së Parë mbi Ecurinë e Çështjes dhe për Parashtrime*, 13 dhjetor 2023, publik; Transkripti i seancës, 15 dhjetor 2023 ("transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes *Shala*"), publik, f. 16-44.

⁹ KSC-2023-11, F00023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje në lidhje me To*, 19 dhjetor 2023, publik, me Shtojcën 1, publike.

¹⁰ KSC-BC-2023-10, F00161, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00161/RED; KSC-BC-2023-11, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake,

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Në bazë të rregullës 96(1) të Rregullores, në vijim të konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes, pas paraqitjes së parë të të akuzuarve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake sipas nevojës organizon konferencat vijuese mbi ecurinë e çështjes, ndër të tjera për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave, për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë përgatitjet e nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore dhe që palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

9. Në bazë të rregullës 96(2) të Rregullores, me pëlqimin me shkrim të të akuzuarit pasi është këshilluar me mbrojtësin, konferenca mbi ecurinë e çështjes mund të mbahet: në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit, me praninë e mbrojtësit ose pjesëmarrjen e mbrojtësit nëpërmjet videokonferencës. Gjithashtu, çdo kërkesë për të marrë pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes përmes videokonferencës, i dorëzohet drejtpërdrejtë Administratores, në përputhje me Udhëzuesin e Punës së Zyrës Administrative për Videolidhjet (KSC-BD/23/COR), dhe në kohë të mjaftueshme paraprakisht në mënyrë që Administratorja të ndërmarrë hapat e duhur dhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake.¹¹

Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës, 8 shkurt 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua në të njëjtën ditë, F00041/RED.

¹¹ *Shih Urdhrin për Konferencën e Dytë mbi Ecurinë e Çështjes Januzi dhe Bahtijari, para. 4 dhe referencat aty.*

10. Në bazë të rregullës 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në që brenda një afati të përcaktuar, të dorëzojë: (i) dosjen paraprake, ku përfshihet çdo pranim në lidhje me faktet nga ana e Mbrojtjes dhe një listë e pikave të pakontestuara; (ii) listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë gjatë gjykimit; dhe (iii) listën e provave materiale që synon të paraqesë gjatë gjykimit, ku përfshihet, kurdo që është e mundshme, çfarëdo kundërshtimi i Mbrojtjes lidhur me autenticitetin e tyre.

11. Në bazë të rregullës 95(5) të Rregullores, pas dorëzimit të materialeve të përmendura në rregullën 95(4) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton Mbrojtjen që brenda një afati të përcaktuar të dorëzojë dosjen e vet paraprake. Gjithashtu, brenda afatit të përcaktuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Mbrojtja informon ZPS-në mbi synimin e vet për të përdorur alibinë ose çfarëdo arsye tjetër që përjashton përgjegjësi penale, ndër të cilat aftësia mendore e kufizuar ose mungesa e aftësisë mendore, intoksikimi, domosdoshmëria, shtrëngimi dhe gabime faktike ose ligjore.

III. DISKUTIM

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se, në bazë të Vendimit Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe Bahtijari* dhe në bazë të Vendimit Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala* (bashkërisht, “Vendimet Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave”), ZPS-ja duhej të përfundonte nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(1)(b) të Rregullores përkatësisht brenda 15 dhjetorit 2023¹² dhe 19 janarit 2024,¹³ dhe t’i dorëzonte Mbrojtjes në të dyja çështjet gjyqësore njoftim të hollësishëm të provave sipas rregullës 102(3) të Rregullores, brenda 26 janarit 2024.¹⁴ Gjithashtu,

¹² Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe Bahtijari*, para. 58, 122(d).

¹³ Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*, para. 59, 111(f).

¹⁴ Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe Bahtijari*, para. 67, 122(e); Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*, para. 68, 111(h). *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-10,

Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se nxjerrja e materialeve shfaqësuese sipas rregullës 103 të Rregullores është kryer përkatësisht më 16 nëntor 2023¹⁵ dhe 26 janar 2024¹⁶, dhe se nxjerrja e materialeve të rregullës 102(1)(b) është kryer përkatësisht më 15 dhjetor 2023¹⁷ dhe 19 janar 2024¹⁸. Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej rikujton se, në përputhje me parashtrimet e ZPS-së dhe urdhrin e tij gojor të 3 nëntorit 2023, ZPS-ja duhej të dorëzonte dosjen paraprake në çështjen gjyqësore *Januzi dhe Bahtijari* brenda 2 shkurtit 2024,¹⁹ si dhe parashihte të dorëzonte dosjen paraprake në çështjen gjyqësore *Shala* në të njëjtën datë.²⁰

13. Në pajtim me rregullën 96(1) të Rregullores dhe për të siguruar përgatitje të shpejtë për gjykim, dhe pas bashkimit të çështjeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh konferencën mbi ecurinë e çështjes për z. Januzi, z. Bahtijari dhe z. Shala, të **martën, 13 shkurt 2024, në orën 10:00.**

14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve të japin përditësime, nëse kanë, lidhur me pikat ende të pazgjidhura të trajtuara në konferencën e tretë

F00154, Prokurori i Specializuar, *Njoftimi i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 26 janarit 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale; KSC-BC-2023-11, F00036, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 26 janar 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

¹⁵ KSC-BC-2023-10, Paketa 4 e materialeve të nxjerrja. *Shih gjithashtu* Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe Bahtijari*, para. 122(j)-(k).

¹⁶ KSC-BC-2023-11, Paketa 6 e materialeve të nxjerrja. *Shih gjithashtu* Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*, para. 111(m)-(n).

¹⁷ KSC-BC-2023-10, Paketa 6 e materialeve të nxjerrja. *Shih gjithashtu* Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Januzi dhe Bahtijari*, para. 122(d). Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se janë nxjerrë materiale të tjera sipas rregullës 102(1)(b) më 19 dhjetor 2023, që ishin incizime me audio dhe video të transkripteve të nxjerrja më herët dhe që i kishin kërkuar Mbrojtja e z. Januzi dhe z. Bahtijari në konferencën e tretë mbi ecurinë e çështjes. *Shih* KSC-BC-2023-10, Paketa 8 e materialeve të nxjerrja, 19 dhjetor 2023. Të njëjtat incizime u nxorën në Çështjen 11 më 19 janar 2024. *Shih* KSC-BC-2023-11, Paketa 5 e materialeve të nxjerrja, 19 janar 2024.

¹⁸ KSC-BC-2023-11, Paketa 5 e materialeve të nxjerrja. *Shih gjithashtu* Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave në Çështjen *Shala*, para. 111(f)-(g).

¹⁹ KSC-BC-2023-10, F00084, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Dytë mbi Ecurinë e Çështjes*, 31 tetor 2023, publike, para. 8; Transkripti i konferencës së dytë mbi ecurinë e Çështjes *Januzi dhe Bahtijari*, f. 82, rreshti 10 deri në f. 82, rreshti 15. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-10, F00159, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake të Prokurorisë*, 2 shkurt 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

²⁰ Transkripti i konferencës së parë mbi ecurinë e çështjes *Shala*, f. 24, rreshtat 8-10.

mbi ecurinë e çështjes *Januzi dhe Bahtijari* dhe në konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes *Shala*, si dhe për parashtrimet e tyre me shkrim e me gojë lidhur me ato pika. Përveç sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të kërkojë përditësime konkretisht për pikat në vijim, sipas renditjes së mëposhtme:

(1) Nxjerrja e materialeve

(a) Cila ka qenë ecuria e nxjerrjes së materialeve provuese nga ZPS-ja, e veçanërisht:

- i. sa u përket materialeve të rregullës 102(1)(b), nëse ZPS-ja mund të konfirmojë se e ka përfunduar nxjerrjen e materialeve brenda afatit të caktuar në Vendimet Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave, d.m.th brenda 15 dhjetorit 2023 dhe 19 janarit 2024, dhe nëse jo, cilat materiale kanë mbetur ende pa u nxjerrë dhe kur do të nxirren;
- ii. sa u përket materialeve të rregullës 102(3), nëse (i) Mbrojtja ka kërkuar apo do të kërkojë qasje përmes procesit të nxjerrjes apo këqyrjes së materialeve të radhitura në njoftimin e hollësishëm të ZPS-së, brenda afatit të caktuar në Vendimet Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave, d.m.th. brenda 9 shkurtit 2024; gjithashtu, nëse ZPS-ja do ta kundërshtojë rëndësinë materiale dhe sa prej materialeve të rregullës 102(3) do të kenë nevojë për redaktime, nëse do të ketë të tilla; dhe (ii) a ka aspekte të pazgjidhura;
- iii. sa u përket materialeve të rregullës 103, nëse ZPS-ja do të nxjerrë materiale shfajësuese të tjera sipas rregullës 103 të Rregullores që janë në ruajtjen, kontrollin apo dijeninë e saj; gjithashtu, nëse dhe sa prej materialeve të rregullës 103 do të kenë nevojë për redaktime, nëse do të ketë të tilla;

- iv. nëse ZPS-ja parasheh kërkesa sipas rregullës 107 të Rregullores; dhe
- (b) Nëse, duke mbajtur parasysh fazën aktuale të nxjerrjes së materialit provues, ZPS-ja po përballet apo parashikon të përballet me ndonjë vështirësi për respektimin e kalendarit të nxjerrjes së provave, të përcaktuar në Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave, sa i përket pjesës së mbetur të procesit të nxjerrjes së materialeve; dhe
- (c) Nëse Mbrojtja kundërshton apo synon të paraqesë kundërshtime në bazë të rregullës 95(2)(e) të Rregullores lidhur me pranueshmërinë e materialeve provuese që janë nxjerrë në bazë të rregullës 102 të Rregullores; dhe në qoftë se po, a do të jetë në gjendje Mbrojtja ta dorëzojë kundërshtimin e saj jo më vonë se **të premtën, 22 mars 2024**.

(2) Përkthimet

- (a) Nëse ZPS-ja po përballet me ndonjë vështirësi sa i përket përkthimit të materialeve provuese.

(3) Hetimet e ZPS-së dhe hapat e ardhshëm

- (a) Kur pritët që ZPS-ja të dorëzojë dosjen paraprake të përditësuar, duke marrë parasysh bashkimin e çështjeve; dhe
- (b) Nëse ZPS-ja ka përfunduar hapat hetimorë të papërfunduar ose kur do të përfundojë këta hapa.

(4) Hetimet e Mbrojtjes dhe hapat e ardhshëm

- (a) Bazuar në përditësimet e ZPS-së lidhur me pikat pararendëse dhe procesin në vijimësi të nxjerrjes së provave, nëse Mbrojtja është – ose kur pret të jetë – në gjendje të japë më shumë informacion për:
- i. ecurinë e hetimeve;

- ii. synimin për të dhënë njoftim për alibi ose arsye që përjashtojnë përgjegjësi penale sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe për nxjerrjen e materialit përkatës sipas rregullës 104(1) dhe (2) të Rregullores;
- iii. nëse Mbrojtja parashikon të dorëzojë dosjen paraprake dhe materialet shoqëruese sipas rregullës 95(5) të Rregullores dhe, në qoftë se po, nëse Mbrojtja do të jetë në gjendje t'i dorëzojë ato deri **të premtën, 12 prill 2024**; dhe
- iv. synimin për të bërë kërkesa lidhur me mundësitë hetimore unike, në bazë të rregullës 99(1) të Rregullores.

(5) Pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen

- (a) A kanë filluar diskutimin palët lidhur me mundësinë e dorëzimit të pikave juridike dhe/ose faktike për të cilat ato pajtohen, sipas rregullës 95(3) dhe 156 të Rregullores; dhe
- (b) Kur mendojnë palët se mund të jenë në gjendje të evidentojnë një listë pikash për të cilat nuk pajtohen dhe një listë pikash për të cilat pajtohen.

(6) Kalimi i pritshëm i dosjes së çështjes sipas rregullës 72(1) të Rregullores:

- (a) në varësi të nxjerrjeve të papërfunduara të materialeve nga ZPS-ja, dhe duke marrë parasysh se Mbrojtja e z. Januzi dhe Mbrojtja e z. Bahtijari nuk kanë paraqitur mocione paraprake, pikëpamjet e palëve për kalimin e dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues deri **të premtën, 3 maj 2024**, në bazë të rregullës 72 të Rregullores lidhur me procedimin e përshpejtuar; dhe
- (b) kur mendojnë palët se do të jenë gati për gjykim.

15. Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron ZPS-në, Mbrojtjen e z. Januzi, Mbrojtjen e z. Bahtijari dhe Mbrojtjen e z. Shala të dorëzojnë parashtrime me

shkrim, nëse dëshirojnë, për cilëndo nga pikat e mësipërme, përfshirë temat e diskutuara në konferencën e tretë mbi ecurinë e çështjes *Januzi dhe Bahtijari* dhe në konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes *Shala*, çfarëdo pike tjetër që nuk është trajtuar në rendin e ditës të konferencave të cekura më lart, ose për çdo vështirësi që lidhet me nxjerrjen e materialeve provuese, jo më vonë se **të hënën, 12 shkurt 2024, në orën 12:00**.

IV. VENDIM

16. Për arsyet e cekura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **VENDOS** të mbajë konferencën mbi ecurinë e çështjes në prani të ZPS-së, Mbrojtjes së z. Bahtijari, Mbrojtjes së z. Januzi dhe Mbrojtjes së z. Shala, në përputhje me paragrafin 13 më lart, **të martën, 13 shkurt 2024, në orën 10:00; dhe**
- b. **URDHËRON** ZPS-në dhe ekipet e Mbrojtjes që, nëse dëshirojnë, të dorëzojnë parashtrime me shkrim lidhur me pikat në paragrafin 14 më lart, deri të hënën, **12 shkurt 2024, në orën 12:00**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 8 shkurt 2024
Në Hagë, Holandë